

Afin que tous soient édifiés

Par Chad H Webb

Premier conseiller dans la présidence générale de l'École du Dimanche

Që Të Gjithë të Jenë të Lartësuar

Nga Vëllai Çad H Ueb,

Këshilltar i Parë në Presidencën e Përgjithshme të Shkollës të së Dieles

Conférence générale d'octobre 2025

À mesure que nous nous concentrons sur Jésus-Christ, enseignons sa doctrine et apprenons diligemment, nous permettons au Saint-Esprit d'approfondir notre foi en Jésus-Christ afin de devenir plus semblables à lui.

On raconte qu'un jeune étudiant qui avait du mal à comprendre un cours à l'université, a embauché un tuteur pour l'aider. Vers la fin de l'année, le professeur a annoncé que, pour l'examen, les étudiants pouvaient amener une feuille de papier sur laquelle ils pouvaient mettre ce qu'ils voulaient. Certains ont noté, en écriture minuscule lisible uniquement à la loupe, ce qu'ils avaient entendu pendant les cours et lu dans les manuels. Notre jeune étudiant est arrivé à l'examen avec une feuille blanche et un homme. Quand le professeur l'a interrogé, le jeune homme a répondu : « Vous avez dit que je pouvais amener une feuille de papier sur laquelle je pouvais mettre ce que je voulais. » Il a alors posé la feuille sur le sol, près de son bureau, et a déclaré : « Je veux que mon tuteur se tienne sur la feuille. »

Le Saint-Esprit

En tant que membres de l'Église de Jésus-Christ des Saints des Derniers Jours bénéficiant de la compagnie d'un membre de la Divinité, nous avons l'aide du tuteur parfait. Le Saint-Esprit connaît toutes choses, témoigne de la vérité et « [nous] rappellera tout ». Le président Nelson parlait souvent de l'importance d'écouter la voix du Seigneur. Il nous a expliqué comment permettre au Saint-Esprit de nous guider et nous a souvent suppliés d'accroître notre capacité spi-

Kur përqendrohemi te Jezu Krishti, e japim mësim doktrinën e Tij dhe mësojmë me zell, ne e ftojmë Frymën e Shenjtë për ta thelluar besimin tonë te Jezu Krishti dhe për të na ndihmuar që të bëhemi më shumë si Ai.

Tregohet një histori për një student universiteti të ri në moshë, i cili po haste vështirësi me një lëndë sfiduese, kështu që ai pajtoi një mësues privat për ta ndihmuar. Afër fundit të kursit, profesori njoftoi se studentët mund të sillnin në provimin përfundimtar një fletë letre në të cilën mund të vendosnin çfarëdo të dëshironin. Disa studentë u përgatitën duke bërë shënime të vockla me informacion nga leksionet dhe librat shkollorë, të lexueshme vetëm po të përdorje një xham zmadhues. Por i riu mbërriti në provimin përfundimtar me një fletë bosh letre dhe një të panjohur. Kur profesori e pyeti atë, i riu u përgjigj: "Ju thatë që mund të sillja një fletë letre me çfarëdo gjëje mbi të". Ai më pas e vendosi letrën mbi dysheme pranë tavolinës së vet dhe tha: "Do të më pëlqente që mësuesi im privat të qëndronte mbi fletën time të letrës".

Fryma e Shenjtë

Si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, të bekuar me shoqërimin e një anëtari të Kreut-Perëndi, ne mund të kemi ndihmën e Mësuesit të përsosur. Fryma e Shenjtë i di të gjitha gjërat, dëshmon për të vërtetë dhe do të na i "kujtojë të gjitha këto [gjëra]". Presidenti Rasëll M. Nelson foli shpesh rreth rëndësisë së vënies vesh të zërit të Zotit. Ai na mësoi se si ta ftojmë udhërrëfimin e Frymës së Shenjtë dhe në mënyrë të përsëritur na u përg-

rituelle de recevoir la révélation.

Je vous invite aujourd'hui à réfléchir au rôle du Saint-Esprit dans l'apprentissage et l'enseignement de l'Évangile, au foyer et à l'église. Le Saint-Esprit nous parvient par la prière de la foi et lorsque nous nous efforçons d'être dignes de ce don précieux. Le manuel de l'Église Enseigner à la manière du Sauveur est inspiré. Il souligne les principes supplémentaires établis par le Seigneur pour nous permettre de favoriser l'influence du Saint-Esprit.

Favoriser un apprentissage diligent

L'un de ces principes est de favoriser un apprentissage diligent. Auparavant, nous pensions que l'enseignement était l'occasion pour un parent ou un instructeur de ressentir l'Esprit en préparant la leçon, pour ensuite faire part de ce qu'il avait appris aux enfants ou aux membres de la classe, dont le rôle était d'écouter. Pourtant, l'enseignement est plus efficace pour nous, apprenants, si nous venons, nous aussi, préparés, et si l'instructeur met en place une expérience d'apprentissage qui favorise la révélation personnelle, dans notre cœur et notre esprit. De plus, quand nous avons l'occasion d'exprimer ce que nous apprenons lors de notre étude et par le Saint-Esprit, nous nous instruisons et nous édifions mutuellement. Lorsque nous mettons en pratique ces principes de l'Évangile, l'Esprit témoigne à nouveau de leur véracité.

Jésus-Christ est l'exemple parfait en tout. Il nous a tous invités à être des apprenants diligents et à prendre la responsabilité de notre témoignage. Il a invité ses disciples à se préparer à apprendre, à parler de ce qu'ils apprennent et à agir avec foi. Il a prié pour eux, a vu leur potentiel divin, les a écoutés, et leur a montré qu'il les aimait et qu'ils étaient importants pour lui.

En tant qu'instructeurs, cherchons davantage à remarquer les progrès des apprenants, à répondre à leurs besoins et à les aider à développer les habitudes spirituelles d'une vie de disciples tout au long de la vie. En tant qu'apprenants, lorsque nous exerçons notre libre arbitre dans le processus d'apprentissage, nous montrons au Saint-Esprit notre disposition à recevoir ses instructions.

Je suis reconnaissant pour une enseignante qui m'a encouragé à devenir un meilleur apprenant. Quand j'ai commencé l'université, je

jërua që ta rritim aftësinë tonë shpirtërore për të marrë zbulesë.

Sot ju ftoj të merrni parasysh rolin e Frymës së Shenjtë, veçanërisht lidhur me të mësuarit dhe mësimdhënien e ungjillit në shtëpi dhe në kishë. Fryma e Shenjtë jepet me anë të lutjes së besimit dhe teksa ne orvatemi të jetojmë të denjë për këtë dhuratë të çmuar. Manuali i frymëzuar i Kishës, Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit, përvijon parime shtesë që Zoti i ka krijuar, të cilat do të ndihmojnë për ta ftuar ndikimin e Frymës së Shenjtë.

Ftoni të Mësuarit me Zell

Njëri nga këto parime është të ftojme të mësuarit me zell. Në të shkuarën, mund ta kemi menduar mësimdhënien si mundësi që një prind ose mësues ta ftojë Shpirtin në përgatitjen e vet dhe më pas t'ua tregojë atë që ka mësuar, fëmijëve ose anëtarëve të klasës, roli i të cilëve ka qenë që të dëgjojnë. Por edhe më e efektshme është kur edhe ne si nxënës vijmë të përgatitur dhe kur mësuesit krijojnë përvoja të të mësuarit që e nxitin zbulesën vetjake drejtpërsëdrejti në zemrat dhe mendjet tona. Më pas, kur na jepen mundësi për ta treguar atë që po mësojmë nëpërmjet studimit tonë dhe nga Fryma e Shenjtë, ne e ndihmojmë njëri-tjetrin që të udhëzohet dhe lartësohet. Kur i zbatojmë parimet e ungjillit, Shpirti përsëri dëshmon për vërtetësinë e tyre.

Si në të gjitha gjërat, Jezu Krishti është shembulli ynë i përsosur. Ai e ka ftuar secilin prej nesh që të jemi nxënës të zellshëm dhe të marrim mbi vete përgjegjësinë për dëshmitë tona vetjake. Ai i ftoi dishepujt e Tij që të përgatiteshin për të mësuar, ta tregonin atë që po mësonin dhe të vepronin me besim. Ai u lut për ta, e kuptoi potencialin e tyre hyjnor, i dëgjoi dhe i ndihmoi të dinin se i donte dhe ata ishin të nevojshëm.

Si mësues, ne mund të përqendrohemi më shumë te përparimi i nxënësit, te plotësimi i nevojave të tyre dhe te ndihma që të zhvillojnë zakonet shpirtërore të dishepullimit gjatë gjithë jetës. Si nxënës, kur e ushtrojmë lirinë tonë të zgjedhjes në procesin e të mësuarit, ne i japim sinjal Frymës së Shenjtë për gatishmërinë tonë që të mësohemi prej Tij.

Jam mirënjohës për një mësuese e cila më ftoi të isha nxënës më i mirë. Kur fillova kolegjin, kisha perceptim të gabuar për shkollën pasi e

voyais à tort les études comme quelque chose à subir avant de pouvoir faire du sport. Un jour, après avoir lu ma dissertation, mon enseignante m'a dit qu'elle pensait que j'étais très doué pour réfléchir de manière analytique. Je ne savais même pas ce que cela signifiait. Elle a déclaré que si je m'appliquais davantage, je serais un bon étudiant. Cela ne m'était jamais venu à l'esprit, mais son intérêt pour moi, ses encouragements et ses invitations ont changé le cours de mes études, et ont été une grande bénédiction dans ma vie.

Enseigner la doctrine

Un autre principe permettant de favoriser la présence du Saint-Esprit est d'enseigner la véritable doctrine. Cela signifie que notre étude et notre enseignement de l'Évangile sont enracinés dans la parole de Dieu, et que nous ne faisons pas d'exagérations et nous ne spéculons pas sur ce que le Seigneur n'a pas révélé. Nous nous concentrons plutôt sur les principes essentiels et éternels qui donnent l'occasion à l'Esprit de témoigner de la vérité. Encore une fois, nous suivons l'exemple du Sauveur. Il a déclaré : « Ma doctrine n'est pas de moi, mais de celui qui m'a envoyé. »

La véritable doctrine se trouve dans les Écritures et les enseignements des prophètes modernes. L'exhortation du Seigneur d'étudier les Écritures personnellement en famille, et d'aller à l'église chaque semaine pour étudier son Évangile, nous donne un cadre remarquable pour apprendre sa doctrine et entendre sa voix. Nous sondons les Écritures pour en comprendre les récits, les principes qu'ils enseignent et la manière de mettre en pratique ces vérités. Quelle bénédiction d'avoir les Écritures à portée de mains. Imaginez Adam et Ève, Abinadi ou même le Maître pédagogue, Jésus-Christ, venir chez nous, ou dans notre classe, pour nous instruire. Ils peuvent le faire quand nous nous faisons un festin de la parole de Dieu. Par nos efforts diligents, nous apprenons à comprendre et à aimer les Écritures. Et nous voyons qu'elles contiennent les réponses aux questions de l'âme.

Quelque temps avant notre mariage, Kristi, ma femme, avait du mal à ressentir l'amour de notre Père céleste et à comprendre son plan pour elle. Elle a prié pour être guidée et elle s'est sentie poussée à participer à l'institut. Elle s'est alors inscrite à un cours sur le Nouveau Testament. La manière dont son instructeur enseignait à

mendoja si diçka që duhej ta duroja me qëllim që të lejohejsh të bëja sport. Një ditë, pasi lexoi një material që e kisha shkruar unë, profesoresha ime më tha se mendonte që isha një mendimtar i talentuar analitik. As nuk e dija se çfarë do të thoshte ajo. Ajo tha se me përpjekje më të përqendruar, mund të isha një student i mirë. Ai mendim nuk më kishte shkuar kurrë ndërmend. Interesimi, inkurajimi dhe ftesat e saj e ndryshuan rrjedhën e arsimimit tim dhe ma bekuan jashtëzakonisht jetën.

Jepeni Mësim Doktrinën

Një tjetër parim domethënës për ta ftuar Frymën e Shenjtë, është të japim mësim doktrinën e vërtetë. Kjo do të thotë se studimi dhe udhëzimi ynë për ungjillin rrënjosen në fjalën e Perëndisë dhe se nuk bëjmë bujë ose spekulime mbi atë që Zoti nuk e ka zbuluar. Përkundrazi, ne përqendrohemi te parimet thelbësore dhe të përvetshme të ungjillit, të cilat e lejojnë Shpirtin të dëshmojë për të vërtetën. Edhe një herë, ne ndjekim shembullin e Shpëtimtarit. Ai tha: “Doktrina ime nuk është e imja, por e atij që më ka dërguar”.

Doktrina e vërtetë gjendet në shkrimet e shenjtë dhe mësimet e profetëve modernë. Porositja e Zotit për t'i studiuar shkrimet e shenjtë individualisht dhe si familjedhe për të frekuentuar kishën çdo javë që të studiojmë ungjillin e Tij, na siguron një strukturë mbresëlënëse për të mësuar doktrinën e Tij dhe për t'ia vënë veshin zërit të Tij. Ne i shqyrtojmë shkrimet e shenjtë që të kuptojmë historinë, parimet që na mësohen atje, dhe zbatimin e këtyre të vërtetave në jetën tonë. Çfarë bekimi është t'i kemi shkrimet e shenjtë në majë të gishtave! Përfytyrojeni Adamin dhe Evën, Abinadin ose madje Mësuesin Mjeshtër, Jezu Krishtin, duke vizituar shtëpitë ose klasat tona për të na dhënë mësim. Ata mundën të na vizitojnë kur ne ushqehemi me bollëk me fjalët e Perëndisë. Me përpjekje të vazhdueshme mund të mësojmë që t'i kuptojmë dhe t'i duam shkrimet e shenjtë dhe të mirëbesojmë se ato kanë përgjigjet ndaj pyetjeve të shpirtit.

Përpara se të martoheshim, pati një periudhë kur bashkëshortja ime, Kristi, e kishte të vështirë të ndiente dashurinë e Atit Qiellor dhe të kuptonte planin e Tij për të. Teksa lutej për udhërrëfim, një mbresë erdhi që ajo duhej të frekuentonte institutin, prandaj u regjistrua në një kurs për Dhiatën e Re. Mënyra se si mësuesi

l'aide des Écritures et même sa façon de les tenir montraient son amour profond pour la parole de Dieu. À mesure qu'elle suivait le cours, le Saint-Esprit lui a murmuré qu'il y avait quelque chose dont elle avait besoin dans les Écritures. L'amour de son instructeur pour les Écritures et les murmures du Saint-Esprit ont suscité en elle le désir d'étudier sérieusement la parole de Dieu. Cette étude s'est transformée en un long parcours de conversion profonde et de service dévoué.

Se concentrer sur Jésus-Christ

Enfin, comme le suggère le manuel Enseigner à la manière du Sauveur, nous devons toujours orienter nos enseignements et notre apprentissage sur Jésus-Christ. Nous devons parler plus souvent de lui, avec plus de révérence, et chercher davantage d'occasions de témoigner et d'exprimer notre reconnaissance et notre amour pour lui. Quel que soit le cadre, lorsque nous nous souvenons de lui, nous avons « son Esprit avec [nous] ».

Nous pouvons mettre Jésus-Christ au centre de notre enseignement en soulignant qu'il est l'exemple parfait, la personnification et l'expression de tous les principes de l'Évangile. Même lorsqu'il n'est pas directement mentionné dans un récit scripturaire, nous pouvons toujours le citer comme exemple du principe enseigné. Il suffit de demander : « Vous souvenez-vous d'un moment où Jésus-Christ a illustré ce principe ? »

Nous pouvons également centrer notre attention sur lui en étudiant ses titres, ses rôles et ses attributs, et en cherchant non seulement à apprendre ce qu'il a fait, mais aussi à mieux comprendre qui il est. Par exemple, lorsque nous étudions le principe du repentir, il est important de comprendre comment le faire. Mais il est aussi essentiel de nous souvenir de ce que Jésus-Christ a fait pour rendre le repentir possible, et de comprendre ce que le repentir nous apprend sur lui, sa nature et ses vertus. Qu'est-ce que la possibilité de nous repentir indique sur son amour, sa patience, sa miséricorde, sa vision de notre potentiel divin, sa disposition à expier nos péchés et la joie qu'il éprouve en pardonnant ? La compréhension de ses titres, tels que l'Agneau de Dieu, le Rédempteur et le Médecin, nous montre que le repentir est son invitation à nous purifier, à nous changer et à nous guérir. En nous concen-

i sa i institutit i jepte mësim shkrimet e shenjtë, madje mënyra se si i mbante ato në dorë, tregon se sa shumë e donte ai fjalën e Perëndisë. Teksa e frekuentonte atë, Fryma e Shenjtë i pëshpëriti asaj se kishte diçka në shkrimet e shenjtë që i nevojitej. Dashuria e mësuësit të saj për shkrimet e shenjtë dhe nxitjet nga Fryma e Shenjtë i ngjallën dëshirën për të filluar një studim serioz të fjalës së Perëndisë, gjë që u bë një rrugëtim gjatë gjithë jetës i kthimit të thellë në besim dhe i shërbimit të përkushtuar.

Përqendrohuni te Jezu Krishti

Së fundi, siç sugjerohet te manuali Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit, mësimdhënia dhe të mësuarit tonë duhet të përqendrohen gjithmonë te Jezu Krishti. Mund të flasim më shpesh dhe me më shumë nderim për Të dhe të kërkojmë më shumë mundësi për të shprehur dëshminë, mirënjohjen dhe dashurinë për Të. Cilido qoftë mjedisi, kur e kujtojmë Atë, ne mund ta kemi "Shpirtin e tij me [vete]".

Një mënyrë për ta vendosur Jezu Krishtin në qendër të mësimdhënies sonë, është që të theksojmë se Ai është shembulli i përsosur, mishërimi dhe shëmbëllimi i të gjitha parimeve të ungjillit. Edhe kur Ai nuk përmendet drejtpërsëdrejti në një rrëfim të shkrimit të shenjtë, propësepropë mund ta përmendim Atë si shembullin e parimit që po jepet mësim. Thjesht mund të pyesim: "A mund të mendoni për një rast kur Jezu Krishti ishte shembull i këtij parimi?"

Gjithashtu mund të përqendrohemi tek Ai duke mësuar titujt, rolet dhe cilësitë e Tij, duke u përpjekur që të mësojmë jo vetëm atë që Ai ka bërë, por edhe për të kuptuar më mirë se kush është Ai. Për shembull, kur studiojmë parimin e pendimit, është e rëndësishme të kuptojmë se si të pendohemi. Por është gjithashtu thelbësore që të kujtojmë atë që Jezu Krishti ka bërë për ta bërë pendimin të mundur dhe që të kuptojmë se çfarë na mëson pendimi rreth Tij, rreth natyrës dhe karakteristikave të vërteta të Tij. Çfarë tregon mundësia jonë për t'u penduar rreth dashurisë, durimit dhe mëshirës së Tij, bindjes së Tij në potencialin tonë hyjnor, gatishmërisë së Tij për të shlyer për mëkatet tona dhe gëzimit që Ai gjen tek falja? Dhe të kuptuarit e titujve të Tij, të tillë si Qengji i Perëndisë, Shëlbuesi dhe Shëruesi, na ndihmon që të kuptojmë se pendimi është ftesa e Tij për të na pastruar, ndryshuar e shëruar.

trant sur ce qu'il a fait pour nous et sur ce que cela nous enseigne sur qui il est, nous développons la « foi qui produit le repentir ».

Il n'est pas toujours évident de voir les attributs du Sauveur dans les récits scripturaux. Par exemple, quand nous lisons le passage où Néphi construit un bateau, nous pourrions avoir tendance à nous concentrer uniquement sur Néphi. Pourtant, en dirigeant notre attention sur le Sauveur, nous voyons que ce récit n'a pas été préservé pour nous parler de la grandeur de Néphi, mais de celle de Dieu, car il nous donne la force de respecter ses commandements et nous délivre dans les moments difficiles.

Nous devons également nous concentrer sur le rôle essentiel de Jésus-Christ dans le plan parfait du bonheur conçu par notre Père céleste. Notre vie change lorsque nous voyons notre situation à la lumière du plan éternel de Dieu, au lieu de la voir à travers le prisme de notre perspective temporelle. L'Évangile n'est pas une liste d'exigences, c'est la bonne nouvelle que Jésus-Christ a vaincu le péché et la mort. En recevant sa grâce infinie par le respect de nos alliances avec Dieu, nous pouvons mener une vie joyeuse dès maintenant et nous préparer à vivre avec notre Père céleste pour l'éternité. En apprenant à voir notre Père céleste et le Sauveur dans les Écritures, nous apprenons à mieux les connaître, et remarquons leur amour et leur influence plus souvent et plus clairement.

Je me souviendrai toujours de l'Esprit que j'ai ressenti dans ma jeunesse pendant que notre instructeur nous parlait des derniers jours de la vie du Sauveur. Il nous a montré l'importance des événements qui se sont déroulés dans la salle haute, à Gethsémané, au Golgotha et dans le sépulcre vide. Il a exprimé sa reconnaissance profonde pour le Sauveur et son désir ardent de le suivre. Son enseignement invitait l'Esprit à témoigner de Jésus-Christ. Et l'Esprit que j'ai ressenti dans cette classe a approfondi ma foi, et a fait grandir mon amour et ma reconnaissance pour le Sauveur. L'influence de cet instructeur m'a accompagnée toute ma vie. Comme il a été dit d'un autre instructeur, « nous aurions pu nous réchauffer les mains à la flamme de sa foi ».

Conclusion

Përqendrimi tek ajo që Ai ka bërë për ne dhe çfarë tregon ajo që ka bërë se kush është Ai, mund të na ndihmojë që të kemi “besim deri në pendim”.

Me raste, mund të mos i shohim menjëherë cilësitë e Shpëtimtarit të përvijuara në një rrëfim të shkrimit të shenjtë. Për shembull, kur lexojmë për Nefin që ndërtoi një anije, ne mund të përqendrohemi vetëm te Nefi. Por përqendrimi te Shpëtimtari mund të na ndihmojë që të kuptojmë se ky anal nuk u ruajt për të na mësuar rreth madhësisë së Nefit, por për të na treguar madhësitë e Perëndisë, se Ai na jep forcë për të zbatuar urdhërimet e Tij dhe na çliron në kohë nevojë.

Gjithashtu mund të përqendrohemi te roli qendror i Jezu Krishtit në planin e përsosur të Atit Qiellor për lumturinë. Ky plan mund ta ndryshojë drejtimin e jetës sonë që t'i shohim rrethanat tona nëpërmjet thjerrave të planit të përjetshëm të Perëndisë, në vend që ta shohim planin nëpërmjet thjerrave të rrethanave tona tokësore. Ungjilli nuk është një listë kërkesash; ai është lajmi i mirë që Jezu Krishti e mundi mëkatin dhe vdekjen. Është me anë të përdorimit të hirit të Tij të mahnitshëm nëpërmjet mbajtjes së besëlidhjeve tona me Perëndinë që ne mund të jetojmë plot gëzim tani dhe të përgatitemi për jetën me Atin tonë Qiellor në përjetësi. Kur mësojmë që t'i shohim Atin Qiellor dhe Shpëtimtarin në shkrimet e shenjta, ne do të arrijmë vërtet t'i njohim Ata më mirë dhe do t'i shohim dashurinë dhe ndikimin e Tyre më shpesh e më fuqishëm në vetë jetën tonë.

Gjithmonë do ta kujtoj Shpirtin që ndjeva në moshë të re kur mësuesi ynë dha mësim rreth ditëve të fundit të jetës së Shpëtimtarit. Ai na ndihmoi të kuptonim rëndësinë e ngjarjeve në dhomën e sipërme, Gjetseman, Golgotë dhe në varrin e zbrazët. Ai shprehu mirënjohjen e tij të thellë për Shpëtimtarin dhe dëshirën e vet të zjarrtë për ta ndjekur Atë. Mësimet e tij ishin një ftesë për Frymën e Shenjtë që të dëshmonte për Jezu Krishtin. Dhe Shpirti që ndjeva në atë klasë, ma thelloi besimin dhe ma shtoi dashurinë dhe vlerësimin për Shpëtimtarin. Ndikimi i atij mësuesi më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës. Siç u tha për një mësues tjetër: “Ne mund t'i ngrohni duart tona nëpërmjet zjarrit të besimit të tij”.

Përfundimi

Dans notre foyer et lors de nos réunions de l'Église, à mesure que nous nous concentrons sur Jésus-Christ, enseignons sa doctrine et apprenons diligemment, nous invitons le Saint-Esprit à approfondir notre foi en Jésus-Christ afin de devenir plus semblables à lui. C'est là le but de tout apprentissage et enseignement de l'Évangile.

Je suis reconnaissant pour mes instructeurs : mes bons parents, mes dirigeants et mes instructeurs locaux, et les hommes et les femmes qui ont été appelés à enseigner et à témoigner à ce pupitre. Tous m'aident à connaître Jésus-Christ et à le suivre. Je suis reconnaissant pour le Saint-Esprit, le tuteur parfait. Grâce au Saint-Esprit, je sais que notre Père céleste nous aime et a un plan parfait pour nous, que Jésus est le Christ, le Sauveur et le Rédempteur du monde, et que son Évangile et son Église ont été rétablis. Je témoigne avec reconnaissance de ces choses, au nom de Jésus-Christ. Amen.

Në shtëpitë tona dhe në mbledhjet e Kishës, kur përqendrohemi te Jezu Krishti, e japim mësim doktrinën e Tij dhe mësojmë me zell, ne e ftojmë Frymën e Shenjtë për ta thelluar besimin tonë te Jezu Krishti dhe për të na ndihmuar që të bëhemi më shumë si Ai, që është qëllimi i të gjithë mësimdhënies dhe të mësuarit të ungjillit.

Jam mirënjohës për mësuesit në jetën time, nga prindërit e mirë dhe udhëheqësit e mësuesit vendorë deri te burrat dhe gratë që janë thirrur për të dhënë mësim e për të dëshmuar nga kjo foltore, të cilët na ndihmojnë ta njohim e ta ndjekim Jezu Krishtin. Dhe jam mirënjohës për Frymën e Shenjtë, Mësuesin e përsosur. Është nëpërmjet Frymës së Shenjtë që e di se Ati Qiel-lor na do dhe ka një plan të përkryer për ne; se Jezusi është Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës dhe se janë rivendosur ungjilli dhe Kisha e Tij. Unë dëshmoj plot mirënjohje për këto gjëra, në emrin e Jezu Krishtit, amen.